



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 190, Datë 13.07.2026

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1565/6 prot., datë 09.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 02.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 02.12.2026.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1565/1 prot., datë 26.05.2026.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 493, Seria T21, është 02.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 02.06.2026.
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 170, datë 15.06.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.06.2026 dhe 17.06.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.06.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1564/4 prot., datë 17.06.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1565/4 prot., datë 26.06.2026, ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet përsa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë procedurë, vlerësohet se janë plotësuar kushtet ligjore dhe rregullatore për rinovimin e licencës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 493, Seria T21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 02.12.2021, për një afat 5 (pesë)-vjeçar, me efekt nga data 03.12.2026.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijenit të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI